

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**Keshilli i Ministrave**

**VENDIM**  
**Nr. 524, date 30.7.2004**

**PER MASEN DHE MENYREN E KOMPENSIMIT TE QIRASE SE BANESES DHE  
TE USHQIMIT TE USHT ARAKEVE TE FORCAVE TE ARMATOSURA TE  
REPUBLIKES SE SHQIPERISE**

Ne mbeshtetje te nenit 100 te Kushtetutes dhe te nenit 21, te ligjit nr.921 0, date 23.3.2004, "Per statusin e ushtarakut te Forcave te Armatosura te Republikes se Shqiperise", me propozimin e ministrit te Mbrojtjes, Keshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Oficeri aktiv i Forcave te Armatosura te Republikes se Shqiperise, qe per shkak te detyres emerohet larg vendbanimit te tij dhe kur nuk trajtohet nga Ministria e Mbrojtjes me banese ose kredi ne vendemerimin e ri, perfiton kompensim per qira banese deri ne ire vjet, ne masen dhe kriteret e percaktuara si me poshte vijon:

a) 70 per qind te cmimit mesatar mujor te tregut per qira banese te tipit garsonier, kur nuk ka persona te tjere ne ngarkim;

b) 70 per qind te cmimit mesatar mujor te tregut per qira banese te tipit 1 + 1, kur ka ne ngarkim deri ne dy persona;

c) 80 per qind te cmimit mesatar mujor te tregut per qira banese te tipit 2+ 1, kur ka ne ngarkim me shume se dy persona.

Cmimi mesatar i qirase se baneses percaktohet, cdo vit, nga Ministria e Financave dhe Ministria e Mbrojtjes, duke u bazuar ne te dhenat e Institutit te Statistikes (INSTAT).

2. Oficeret, qe perfitojne kompensim per qira banese, duhet te paraqesin prane struktures ushtarake perkatese keto dokumente:

a) Kerkesen per kompensimin e qirase se baneses;

b) Certifikaten personale;

c) Certifikaten familjare;

y) Urdhrin e ministrit te Mbrojtjes per emerimin ne detyre jashte vendbanimit;

d) Kontraten e qirase se baneses, te noterizuar.

J 3. Ushtaraku aktiv i Forcave te Armatosura (oficer, nenoficer dhe ushtar profesionist), i emeruar jashte vendbanimit, i cili nuk e ka ndryshuar vendbanimin familjar, pasi nuk ka patur mundesi strehimi, dhe nuk perfiton kompensim per qira banese, gezon te drejten e kompensimit ne vlere per ushqim, per tre vakte, sipas normes nr. 4, te percaktuar ne vendimin nr.160, date 9.7.1995, te Keshilli t te Ministrave, te ndryshuar, te trajtimit me ushqim te efektivave, per ditet efektive te punes.

4. Ushtaraket e tjere te sherbimit aktiv gezojne te drejten e kompensimit ne vlere per ushqim vetem per vaktin e drekes, sipas normes lirA, te percaktuar ne vendimin nr.160, date 9.7.1995, te Keshillit te Ministrave, te ndryshuar, te trajtimit me ushqim te efektivave, per ditet efektive te punes.

5. Masa e vleres per kompensimin e ushqimit percaktohet, cdo vit, nga ministri i Mbrojtjes, ne baze te cmimeve mesatare vjetore, sipas buletinit te Ministrise se Bujqesise dhe te Ushqimit.

\_6. Kur ushtaraku thirret ne repart per nevoja sherbimi (gatishmeri, stervitje, fushime) trajtohet me ushqim te gatuar sipas normes se repartit dhe nuk perfiton kompensim ne vlere.

7. Vendimi nr.505, date 24.10.1994, i Keshillit te Ministrave, "Per trajtimin me ushqim te kuadrove ushtarake aktive, qe sherbejne ne strukturat e ushrise", i ndryshuar, nuk zbatohet per ushtaraket e Ministrise se Mbrojtjes.

8. Efektet financiare, qe rrjedhin nga zbatimi i ketij vendimi, te perballohem nga buxheti i miratuar per Ministrine e Mbrojtjes.

9. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes dhe ministri i Financave te nxjerrin udhezimin perkates per zbatimin e ketij vendimi.

Ky vendim hyn ne fuqi pas botimit ne "Fletoren zyrtare".

**KRYEMINISTRI  
FATOS NANO**

**MINISTRI I MBROJTJES  
PANDELI MAJKO**